



REPUBLIKA E MAQEDONIS SË VERIUT
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Komisioni shtetëror për parandalimin e korrupsionit, në bazë të nenit 22 dhe 23 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" Nr. 12/2019) nenit 40 dhe 41 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, dhe neni 4 nga udhëzimi për renditjen e lëndëve për veprim të KSHPK-së në bazë të denoncimeve të parashtruar, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues anonim në seancën e 50-të, të mbajtur më 22.07.2021, morri vendimin vijues:

VENDIM

Denoncimi i parashtruar nga parashtrues anonim - grup i banorëve të -----, në Komisionin Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, mbi bazë të së cilës u formua lënda me numër 12-1269 / 1 të datës 23.03.2021, REFUZOHET.

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesave, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, pasi shqyrtimit të përmbajtjes së lëndës, përcaktoi se nuk ka elemente për veprim kompetent mbi të njëjtën.

Lënda me numër 12 –1269/1 të datës 23.03.2021 të mbyllet dhe të arkivohet .

Vendimi i KSHPK-së, me arsyetim - në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

Arsyetim

Lënda me numër 12-1269 / 1 të datës 23.03.2021 u formua në bazë të denoncimit nga parashtrues i panjohur - grup banorësh të -----.

Në denoncim theksohet se e njëjta është ngritur kundër Kryetarit të Komunës ----- dhe dyshohet se i njëjti e kqëpërdori funksioni i tij, dhe kështu detyra e tij zyrtare si Kryetar Komune, sepse lejon, jep, ndan, miraton ndërtimin e objekteve në qendër të ----- . Theksohet se në mënyrë të paligjshme jep tokë njerëzve të tij të afërt dhe lejon të ndërtohen objekte pa asnjë dokument, sepse janë njerëzit e tij të ciët si shkëmbim do të votojnë për të, si dhe se ka nga ata prej të cilëve ka marrë ryshfet, para që të mund të ndërtojnë në qendër të ----- . Në vazhdim theksohet se ambiente të tilla që mund të shihen edhe nga zyra e tij janë: shtëpi në ----- - shtëpi në 3 kate me lokale afariste; dyqan sanduiçesh në ----- - ndërtesë e re ndërtim i fortë; stacioni i autobusëve - ndërtesë e re ndërtim i fortë. Në vazhdim të denoncimit theksohet se ai personalisht këto objekte të rëndësishme i lidhi me

energji elektrike, personalisht nēpērmjet ndērmarrjes komunale i lidhi ato me ujē dhe kanalizim dhe ai personalisht me makinē tē komunēs ju ndihmoi deri sa ishin duke u ndērtuar

Parashtruesit e denoncimit theksojnē se e denoncojnē kētē rastē dhe rastet kur ai u jep para njerēzve tē tij se punuan diēka pēr komunēn dhe me ta lidhi kontrata dhe pastron parat, siē janē kumbarēt e tij, gjyshi prej gruaje, tē afērmit, anētarēt e partisē dhe tē tjerēt dhe mijēra raste tē tilla kērkojnē qē e nējta tē kontrollohet.

Pas shqyrtimit dhe analizimit tē pohimeve nga denoncimi, KSHPK konstaton se nuk ka tē dhēna tē mjaftueshme pēr ti konkretizuar ndērtesat e treguara nē bazē tē tē cilave do tē kērkoreshin tē dhēna dhe informacione pēr veprime tē mētejshme nē KSHPK. E nējta gjē vlenē edhe pēr pohimet pēr lidhjen e kontratave nē vepēr, nuk janē treguar persona specifik dhe arsyet mbi tē cilat janē lidhur kontratat, dhe nga ana tjetēr parashtruesi ēshtē i panjohur si ēshtē kontaktuarē me qēllim pēr tē marrē tē dhēna dhe informacione shtesē. Prandaj, nē seancē, Komisioni Shtetēror pēr Parandalimin e Korrupsionit vlerēsoi se nuk ka elementē pēr veprimin e tij kompetent sipas lēndēs nē pērputhje me nenin 17 tē Ligjit pēr Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit tē Interesit.

Duke pasur parasysh tē theksuaren mē sipēr, Komisioni Shtetēror pēr Parandalimin e Korrupsionit, nē bazē tē nenit 22 dhe 23 tē Ligjit pēr Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit tē Interesave ("Gazeta Zyrtare e Republikēs sē Maqedonisē" Nr. 12/19), vendosi si nē dispozitēn tē kētij vendimi.

Pērgatiti: M.r.B.K.SH, Kēshilltar
Miratoi: M.r.SH.S, Anētar i KSHPK-sē

KOMISIONI SHTETOROR
PĒR PARANDALIMIN E
KORRUPSIONIT
Kryetar
Biljana Ivanovska